

Data 06.07.2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shpenzime për Sigurimin e jetës së punonjësve zjarrfikëse”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi  
CPV: 66511000-5- Shërbimevtë sigurimit e jetës**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë pa TVSH.**

**PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS:**

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës me objekt: **“Shpenzime për Sigurimin e jetës së punonjësve zjarrfikëse”**

Në zbatim të urdhërit e grupit të Specifikimeve teknike Nr. 201 date 14.06. 2023 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës, “Mbi Hartimin e Specifikimeve Teknike (Termet e References) si dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit të Kontratës së Prokurimit të planifikuar për tu kryer në programet e shpenzimeve për vitin 2023.

Pasi u njoh me objektin e prokurimit nëpërmjet dokumenteve :

“Shpenzime për sigurimin e jetës së punonjësve zjarrfikëse”

Objekti: – **Shpenzime për Sigurimin e jetës së punonjësve zjarrfikëse**

dhe pasi i shqyrtoi ato, programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me përcaktimin e specifikimeve teknike të shërbimit “Sigurim Jete për Punonjësit Zjarrfikës” , objekt i këtij prokurimi , si dhe grumbullimin e informacionit, lidhur me çmimet orientuese në mënyrë për të përlllogaritur vlerën limit të kontratës, për caktimin e kriterëve të veçanta të pranimit, lidhur me kushtet e shërbimit.

**II. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, komisioni u mbështet në informacionin e marrë nga:

Kërkesa e MZSH –së (si kërkesa themelore bazë e përcaktuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave) , Drejtoria e Përgjithshme e MZSH –së, si dhe informacione të marra nga kompani të sigurimit të jetës, nga interneti etj.

Pas shqyrtimit të informacionit mbi të dhënat teknike komisioni vërejt se:

*Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11. 2006, “Për Prokurimin Publik”, neni 23.*

### **III. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS**

**Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 neni 76 ,sipas të cilit:**

1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a)** çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b)** studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c)** çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç)** çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

**Komisioni organizoi punën për Kërkimin dhe Grumbullimin e Informacionit mbi Çmimet Orientuese për shërbimin , objekt i këtij prokurimi;**

**Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:**

- 1. Listat e publikuara** nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e shërbimit që kërkohet të prokurohet.
- 2. Institucione të tjera zyrtare** të njohura, si Këshilli i Ministrave me VKM nr. 382 date 13.05.2020 disponon publikime lidhur me çfarë kërkohet.
- 3. Kompanitë e sigurimeve për jetën.**

**Grupi u mbështet:**

- 1. Në VKM nr. 382 date 13.05.2020 Për “Sigurimin e Jetës së Punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”**

2. Nga kërkimet e bëra në internet tek kompanite që operojnë në fushën e sigurimit të jetës.

3. Ofertat e Kompanive të sigurimit.

Në përfundim, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit tregtar dhe pasi i përpunoi ato, rezultoi se:

Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull ;

**BLERJE: “Shpenzime për Sigurimin e jetës së punonjësve zjarrfikëse ”** për 44 punonjës zjarrfikës

rezultoi të jetë respektivisht:

1.100.000 ( nje milion e njëqind mijë) lekë

Mbështetur në rezultatin e sipër nxjerrë, Komisioni **me unanimitet** ;

### **V E N D O S I :**

Të përcaktojë Vlerën Limit të Kontratës ;

**Për një shumë prej 1.100.000 lekë**

Për prokurimin me titull :

**BLERJE: “Shpenzime për sigurimin e jetës së punonjësve zjarrfikës” për 44 punonjës.**

Afati i mbuluar me periudhë sigurimi do të jetë 1 ( një) vit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

---

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 440'000 Lekë

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

---

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

*Kerkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure,si dhe mbeshetet ne ne nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

*Shërben për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, me qëllim për të parë aftësitë financiare të operatorëve ekonomikë*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2023 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore, ligjin nr.131/2015 ”Per Qendren Kombetare te Biznesit”neni 3.1(a,b,c). Dokumentat e kerkuara me siper, do te paraqiten nga operatori ekonomik fitues para dhenies se kontrates ose nese kerkohen sqarime nga A.K.*

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 220'000 lekë

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Referuar fondit limit sipas nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

---

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme të lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) (shënim- përcaktoni, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).

- Licensë e lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) referuar ligjit nr. 52/2014 “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe të Risigurimit” Aneksi I, B klasa 19.
- Eksperiencë 3 vjeçare në veprimtarinë e sigurimit të jetës,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjit nr. 52/2014 “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe të Risigurimit” Aneksi I, B klasa 19

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

*Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:*

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **2.4.1.....**

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

## **1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor**

Emri Bashkia Durrës  
Adresa Sheshi "Liria", Qyteti Durrës  
Tel/Faks 052 22 23 10  
E-mail [info@durres.gov.al](mailto:info@durres.gov.al)  
Ueb-faqe [www.durres.gov.al](http://www.durres.gov.al)

**2. Lloji i procedurës së prokurimit:** Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Shërbim

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-74474-07-06-2023

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** "Shpenzime për Sigurimin e jetës së punonjësve zjarrfikëse"

**5. Fondi limit:** 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë pa TVSH.

**6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 1 vit ( 12 muaj)

**7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:** 17.07.2023 Ora: 10:00

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anetareve të njësive kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).